

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	EMRI/ Hyri të vidhte me 4 të tjerë, por vritet nga pronari italian i banesës, zbulohet identiteti i shqiptarit 3 6-vjeçar
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/emri-hyri-te-vidhte-me-4-te-tjere-por-vritet-nga-pronari-it-alian-i-ba-i46869
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 17:53:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 17:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b14b56b6e1f886e25a58b2a7a8a27dcc543ad04bd78e3a78cfd467cf42a46526
TEKSTI	f4e7eac4c20bbf6f800ebe4f17f03312c9b00c27c818c2ebe9c475ea4b7a712c
PAMJA	2f44c13d2b65cb024b72a49d70c90739a0a70d3ab05ca354870e2676a1f24cef

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3eb7fa18d03aa476770010d5282047d2af48780ac871892ff97ee6070ca5e6ea
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e2945722f337a24a4a420f547970a54f85bbd4148edb6362f4a6ae2b4457515b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3eb7fa18d03aa476770010d5282047d2af48780ac871892ff97ee6070ca5e6ea>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Ekzekutohet “Tani i Rruzhiut” në zemër të Sarandës, autorët me motor dhe skafandra e qëlluan sapo doli nga lokali! Hita takim urgjent me strukturat e policisë](#)

20 Shtator 2026, 10:23

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

—

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 20 Shtator 2026, 19:10

EMRI/ Hyri të vidhte me 4 të tjerë, por vritet nga pronari italian i banesës, zbulohet identiteti i shqiptarit 36-vjeçar

Sipas hetimeve paraprake, Lazri dyshohet se kishte hyrë në oborr së bashku me të paktën katër persona të tjerë, me qëllim vjedhjen e materialeve të ndërtimit.



Zbardhet identiteti i shqiptarit që u vra nga pronari italian teksa po grabiste një banesën e tij.

Ai është 36-vjeçari Gjovalin Lazri, i cili ka humbur jetën pasi u qëllua me armë zjarri në Baldissero d'Alba, në provincën e Cuneos, Itali.

Ngjarja ka ndodhur gjatë natës mes së shtunës dhe të dielës, në një pronë që po rikonstruktohej. Sipas hetimeve paraprake, Lazri dyshohet se kishte hyrë në oborr së bashku me të paktën katër persona të tjerë, me qëllim vjedhjen e materialeve të ndërtimit.

Grupi dyshohet se ka mbërritur rreth orës 02:30 në pronën e 35-vjeçarit Roberto Mollo, ku ndodheshin materiale ndërtimi me vlerë disa mijëra euro, mes tyre çimento, pllaka, tjegulla, vegla dhe skela.

Mollo, i cili ndodhej në pronë, ka deklaruar se është zgjuar nga zhurmat dhe ka marrë një pistoletë gjysmëautomatike, me të cilën ka qëlluar disa herë në drejtim të personave që ndodheshin jashtë.

Të dyshuarit e tjerë kanë arritur të largohen, ndërsa Lazri është plagosur rëndë. Pavarësisht ndërhyrjes së ekipeve mjekësore, 36-vjeçari ka ndërruar jetë pak më vonë.

Mollo është vënë nën hetim për vrasje me dashje. Arma ishte e regjistruar në emër të tij, por autoritetet po verifikojnë nëse ai kishte të drejtë ta mbante atë në pronën ku ndodhi ngjarja.

Lazri kishte origjinë shqiptare dhe prej vitesh jetonte në Torino me familjen. Ai drejtonte një bar në Corso Taranto së bashku me partneren dhe kishte një djalë. Sipas avokates së familjes, Roberta Sisimbri, 36-vjeçari kishte një precedent penal për krime kundër pronës, por ishte duke punuar dhe po përpiqej të riintegrohej në shoqëri.

Trupi i viktimës është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Torino, ndërsa pritet kryerja e autopsisë/Versus.al

Poll



AKTUALITET

[Ministri i Brendshëm e nis detyrën e re me Rinasin. Demo vlerën policinë kufitare për përballimin e fluksit](#)

20 Shtator 2026, 18:25

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Dibër/ Ra në kontakt me rrymën elektrike teksa peshkonte, humb jetën 31-vjeçari](#)

20 Shtator 2026, 18:05

^ekstrakti^



AKTUALITET

[“Jo në emrin tim”, shqiptarët protestojnë në Vjenë kundër vendimit të Hagës](#)

20 Shtator 2026, 17:40

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Aksident në aksin Peshkopi-Maqellarë, plagosen nënë e bir nga Kukësi. Nisen me urgjencë drejt Tiranës](#)

20 Shtator 2026, 17:31

^ekstrakti^





AKTUALITET

[VIDEO/ Ekzekutimi i 44-vjeçarit, Hita mbërrin me urgjencë në Sarandë. Takim me strukturat vendore të policisë](#)

20 Shtator 2026, 17:12

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Zjarr në Babiçë të Vlorës, flakët rrezikojnë një banesë](#)

20 Shtator 2026, 17:07

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Hyri për të grabitur pronën, shqiptari q*llohet për vd*kje nga pronari italian](#)

20 Shtator 2026, 16:14

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Skandal/ Publikohet videoja kur zyrtari serb përdorte fjalor banal gjatë gjyqit në Hagë!](#)

20 Shtator 2026, 14:53

^ekstrakti^

[Të fundit](#)





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.